



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë – seanca në orën 11:00. (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 15.02.2024.)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.

7. Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. {...}, përfaqësues i ILD-së.

10. {...}, gjyqtare.

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë – seanca në orën 11:00. (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 15.02.2024.)

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është me një delegacion të huaj në takim, kështu që e ka të pamundur për të qenë prezent në këtë mbledhje.

Mbledhja do të drejtohet në vijim nga ana ime, Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur dhe do të vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e këtij rendi dite është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Seanca është përcaktuar sot në orën 11:00 dhe është shtyrë nga mbledhja plenare e datës 15.02.2024.

Ftoj administratën të bëjë njoftimet përkatëse për përfaqësuesin e Inspektorit dhe subjektin/magjistrate {...}.

(Hyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe gjyqtarja znj. {...}).

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Në vijim të kësaj seance dëgjimore, prezent është personi i autorizuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. {...}, me detyrë inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor nr. 1/2024, në ngarkim të magjistrates {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të zhvilluar pranë KLGJ-së. Autorizimi mban nr. {...} prot., datë 29.02.2024.

Është paraqitur edhe magjistratja {...} që është prezent në sallë.

Në vijim të seancës ftoj përfaqësuesin e ILD-së të parashtojë në mënyrë të përmbledhur parashtrësat e veta.

{...}: Faleminderit zoti drejtues i seancës!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Shkurtimisht po ju paraqes një parashtrësë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor mbi bazë ankese ndaj magjistrates

{...}, gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Shtetasja {...} i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me ankesën e regjistruar me nr. {...} prot., datë 13.09.2021. Ankuesja ka parashtruar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është gjykuar çështja civile me palë: paditës {...} etj; i paditur {...}; me objekt: Dhënie detyrimi ushqimor...etj. Kjo çështje i ka rënë për shqyrtim gjyqtares {...}, e cila pasi ka përfunduar gjykimin e çështjes së mësipërme, ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar dorëzimin e vendimit gjyqësor të arsyetuar në sekretarinë e gjykatës. Ankuesja shprehet se i ka kërkuar disa herë gjyqtares {...}, që t'i vendoste në dispozicion vendimin gjyqësor të arsyetuar, ndërkohë që është përcjellë nga gjyqtarja, e cila, sipas ankueses, nuk ka përmbushur detyrimin që e ngarkon ligji.

Nga shqyrtimi i të dhënave të administruara në procesin e verifikimit rezultoi se çështja civile e sipërpërmendur, ka përfunduar me vendimin nr. {...}, datë 22.04.2021, të dhënë nga gjyqtarja e çështjes {...}. Për gjykimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar 10 seanca dhe gjykimi ka përfunduar në datë 22.04.2021, me një kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj. Ndërsa, dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar në sekretari në datën 14.10.2021, me një afat prej 5 muaj e 22 ditë në kundërshtim me nenin 308 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

Pavarësisht se, verifikimi i ankesës kishte filluar lidhur me pretendimin e ankueses {...}, për vonesa nga ana e gjyqtares {...}, në zbardhjen dhe dorëzimin e arsyetuar në sekretari të vendimit nr. {...}, datë 14.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga verifikimi rezultoi se kjo gjyqtare kishte një numër të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore që janë zbardhur dhe dorëzuar me vonesë në sekretarinë e gjykatës. Nga 20 vendime gjyqësore të dhëna për periudhën 01.04.2021 - 22.04.2021, vetëm dy vendime gjyqësore janë dorëzuar të arsyetuar në sekretari brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, ndërkohë për 18 (vendime) të tjera rezulton se ato janë dorëzuar përtej afatit ligjor që shkon nga 7 (ditë) me vonesë, deri në 331 ditë me vonesë.

Në analizë të fakteve të konstatuara ekzistonin dyshime të arsyeshme të bazuara në provat e marra gjatë verifikimit të ankesës, se nga ana e magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mund të

ishite kryer shkelja disiplinore e parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronjat “d” të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. {...} prot., datë 14.07.2023 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.

Në mbështetje të parashikimeve të nenit 100, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016, parashikohet detyrimi për të hetuar nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore. Ky detyrim lidhet me dokumentimin e saktë të fakteve që japin shkaqe të mjaftueshme lidhur me veprime apo mosveprime të magjistratit për të krijuar bindjen se ka ndodhur një shkelje disiplinore. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me hetimin disiplinor janë hetuar kryesisht të gjitha faktet, si dhe janë vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme në funksion të këtij hetimi disiplinor.

Për këtë qëllim, në mbështetje të nenit 132 të ligjit nr. 96/2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, në kuadër të këtij hetimi disiplinor janë kërkuar dhe administruar në cilësinë e provës dokumentacioni i paraqitur nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo dhe të dhënat e dërguar nga vetë magjistratja {...}.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ndër të tjera udhëhiqet edhe nga parimi i ligjshmërisë në kuptimin që ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur në shkelje disiplinore.

Nga veprimet hetimore të kryera dhe provat e mbledhura në funksion të hetimit disiplinor, rezulton se gjyqtarja {...} në përfundim të gjykimit të çështjes objekt hetimi disiplinor, me vendimin nr. {...}, datë 22.04.2021, ka vendosur për pranimin e kërkesëpadisë. Lënien e fëmijës për rritje dhe edukim paditëses {...}. I padituri, të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën, në shumën 21.000 (njëzet e një mijë) lekë në muaj. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes së padisë datë 20.06.2020.

Ndërkohë, nga fleta e regjistrit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në kryesekretari, rezulton se vendimi është arsyetuar dhe dosja është dorëzuar në kryesekretari në datë 14.10.2021 për një afat 5 muaj dhe 22 ditë.

Dorëzimi i këtij vendimi në këtë afat tejet të gjatë, rezulton të jetë në kapërcim të afatit 20-ditor të parashikuar në nenin 308, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

Paditësja {...}, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Gjykatën e Apelit Tiranë (aktualisht Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm), ankim i regjistruar më datë 11.11.2021.

Gjykata e Apelit, me vendimin nr. {...}, datë 18.07.2023, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë 22.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke ndryshuar vetëm disponimin në lidhje me masën e detyrimit ushqimor për fëmijën {...}, si: detyrimin e të paditurit {...} të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën në shumën 25,000 (njëzetë e pesë mijë lekë) në muaj (nga 21.000 (njëzet e një mijë) lekë që ishte përcaktuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë).

Nga provat e marra gjatë hetimit rezulton se mosveprimi i gjyqtarës {...} nëpërmjet mosarsyetimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në afatin e parashikuar dhe duke vepruar me vonesë tej çdo afati të arsyeshëm dhe objektiv ka sjellë si pasojë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, si dhe kryerjen e veprimeve të tjera procedurale në kuadër të këtij procesi.

Gjatë hetimit disiplinor magjistratja {...}, pasi është njoftuar dhe ka marrë dijeni për fillimin e hetimit disiplinor, si dhe me njohjen e të drejtave përgjatë hetimit, ka depozituar parashpresa me shkrim si dhe ka bashkëlidhur dhe akte si, kopje të raporteve mjekësore, shkresa të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë lidhur me ngarkesën në punë dhe shpalljen e vendimeve gjyqësore nga data 01.01.2021-10.09.2021.

Ndër të tjera magjistratja {...} ka shpjeguar se: “Në lidhje me dorëzimin jashtë afatit ligjor të dosjes në fjalë, si dhe të dosjeve të tjera të cituara në vendimin Tuaj, sqaroj se në muajin Shkurt dhe në muajin Mars të vitit 2021 gjendja ime shëndetësore ka qenë shumë e rënduar si pasojë e infektimit me virusin Covid-19, gjendje e cila ka vijuar dhe më pas pasi jam kthyer në punë me datë 23.03.2021 dhe për një periudhë disa mujore. Ndërkohë gjatë muajit Gusht kam qenë gjyqtare e gatshme me urdhrat e menjëhershëm të

mbrojtjes. Gjithashtu ndikim në vonesat lidhur me dorëzimin me vonesë të vendimeve gjyqësore të arsyetuara ka pasur dhe fakti se gjatë kësaj periudhe kam qenë në proces vetingu, për të cilën për efekt detyrimi ligjor sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe përmbushja në tërësi e kërkesave të Komisionit kërkonte kohë të konsiderueshme, pasi për këtë më është dashur të shkoj personalisht nëpër institucione”.

Në vlerësim të pretendimeve të parashtruara, në raport dhe me aktet e paraqitura nga vetë subjekti i hetimit disiplinor si dhe aktet e administruara gjatë hetimit ka rezultuar se, për periudhën 01.01.2021 – 31.03.2021 gjyqtare {...} ka shpallur 16 vendime gjyqësore në intervale të datave 15.01.2021 deri me datë 04.02.2021.

Referuar datave të dorëzimit të tyre të arsyetuara në sekretari rezulton se, asnjë nga vendimet nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor, ndërsa janë dorëzuar në një afat prej më shumë se: i) 2 muaj, 3 vendime; ii) 3 muaj, 10 vendime; iii) 9 muaj, 1 vendim; iv) 11 muaj, 1 vendim dhe v) 1 vendim, 1 vit e dy muaj. Nisur nga kjo analizë duke zbritur periudhën e mungesës në punë të gjyqtarës {...} si pasojë e sëmundjes (06.02.2021 – 06.03.2021) apo për shkak të lejes vjetore (08.03.2021-23.03.2021) nuk rezulton që asnjë vendim të jetë dorëzuar brenda afatit ligjor.

Ndërsa brenda periudhës 01.04.2021-10.09.2021 (data e shkarkimit nga detyra me vendim të KPK), gjyqtarja {...} nuk është paraqitur në punë për arsye të justifikuara gjithsej 23 ditë, konkretisht në datat 02.06.2021-05.06.2021 dhe 10.06.2021-12.06.2021 për paaftësi të përkohshme për shkak sëmundje si dhe në datat 02.08.2021-13.08.2021 dhe 24.08.2021-31.08.2021 për shkak të qenies me leje vjetore. Periudha të cilat nuk përbëjnë shkaqe objektive që mund të kenë ndikuar për dorëzimin me vonesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor nr. {...}, datë 22.04.2021, objekt hetimi.

Nga hetimi i zhvilluar nuk u konstatuan as kryesisht shkaqe apo rrethana të cilat të justifikojnë vonesën në arsyetimin e vendimit gjyqësor nr. {...}, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga ana e magjistrates {...}.

Për rrjedhojë vlerësohet se nga ana e magjistrates {...} është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016.

Pra rezulton se si pasojë e mosveprimit në kohë dhe vonesës së pajustificuar tej çdo afati të arsyeshëm dhe objektiv të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë, ka sjellë si pasojë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, zvarritje në kryerjen e veprimeve të tjera procedurale në kuadër të këtij procesi, si depozitimi i ankimit nga ana e palës paditëse dhe për rrjedhojë edhe vonesa në shqyrtimin e ankimit të saj nga një gjykatë më e lartë, Gjykata e Apelit Tiranë.

Duke pasur në konsideratë natyrën e veprimeve apo mosveprimeve të cilat përbëjnë shkelje disiplinore objekt hetimi disiplinor, në rastin konkret duhet të mbahet në konsideratë edhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, i cili argumenton kushtet dhe rrethanat në të cilat shkeljet e kësaj natyre, ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin kur: (i) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustificuara; (ii) këto vonesa kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë (sidomos në rastet kur ndaj vendimit që pritet të dorëzohet i arsyetuar është ushtruar ankim); (iii) këto vonesa nuk justifikohen nga ngarkesa e punës që ka gjyqtari apo nga kompleksiteti i çështjeve që ai ka në shqyrtim; (iv) këto vonesa nuk justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me gjyqtarin; (v) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv; (vi) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësia.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se edhe duke marrë në konsideratë shkaqet e mësipërme objektive, vendimet gjyqësore duhet të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm. Në çdo rast duhet të gjenden zgjidhje ligjore brenda institucionit në mënyrë që dorëzimi i tyre të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor.

Nisur nga natyra e çështjeve të cilat janë trajtuar nga ana e magjistrates {...} në periudhën 01.01.2021-21.04.2021 rezulton se ajo ka përfunduar 35 çështje, nga të cilat 18 çështje me objekt zgjidhje martesë dhe 17 çështje të tjera me objekt lëshim urdhra të menjëhershëm mbrojtje dhe urdhra mbrojtje apo për çështje të tjera familjare, vendime për të cilat lidhur me datën e dorëzimit të arsyetuar të tyre në sekretari ka rezultuar si më poshtë:

- i. çështje të natyrës me objekt “zgjidhje martesë”:
 - të arsyetuara brenda afatit ligjor, për një afat kohor 13 ditë dhe 7 ditë, rezultojnë

2 vendime;

- të arsyetuara për një afat nga 21-31 ditë, rezultojnë 2 vendime;
- të arsyetuara për një afat nga 31-60 ditë, rezulton 1 vendim;
- të arsyetuara për një afat nga 61-90 ditë, rezultojnë 2 vendime;
- të arsyetuara për një afat nga 91-120 ditë, rezultojnë 8 vendime;
- të arsyetuara për një afat nga 121-150 ditë, rezultojnë 2 vendime;
- të arsyetuara për një afat mbi 181 ditë, rezultojnë 2 vendime.

Gjithashtu, nga të dhënat e marra konstatohet se për periudhën 22.04.2021 (data e shpalljes së vendimit nr. {...}), deri më 14.10.2021 (data e dorëzimit të arsyetuar të këtij vendimi), gjyqtarja {...} ka shpallur 140 vendime gjyqësore, nga të cilat:- vetëm 11 prej tyre ose 7.8% janë dorëzuar brenda afatit; - 8 prej tyre ose 5.7% janë dorëzuar për një afat nga 20 deri 30 ditë; - 15 prej tyre ose 10.7% janë dorëzuar për një afat nga 31 deri 60 ditë; - 10 prej tyre ose 7% janë dorëzuar për një afat nga 61 deri 90 ditë; - 14 prej tyre ose 10% janë dorëzuar për një afat nga 91 deri 120 ditë; - 23 prej tyre ose 16.4% janë dorëzuar për një afat nga 121 deri 150 ditë; - 25 prej tyre ose 17.8% janë dorëzuar për një afat nga 151 deri 180 ditë; - 34 prej tyre ose 24.2% janë dorëzuar për një afat mbi 181 ditë.

Nga të dhënat e marra gjatë hetimit rezulton se përgjatë periudhës që është dorëzuar me vonesë vendimi nr. {...}, datë 22.04.2021, gjyqtarja {...}, rezulton të ketë vonesa të theksuara në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara në 14 prej tyre në një afat prej më shumë se 3 muaj, 23 prej tyre në një afat më shumë se 4 muaj, në 25 prej tyre në një afat prej më shumë se 5 muaj dhe në 34 prej tyre në një afat prej më shumë se 6 muaj.

Pra rezulton se vonesa në arsyetimin e vendimit nr. {...}, datë 22.04.2021 nuk është e vetme, ajo është e përsëritur në afate të konsiderueshme dhe tej afatit ligjor 20-ditor të parashikuar në nenin 308 të KPC.

Vonesat e evidentuara më lart, si në rastin e vendimit objekt hetimi disiplinor ashtu dhe rastet e sipërcituara ku përsëritet e njëjta shkelje, rezulton të jenë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv.

Nga të gjitha provat e marra gjatë hetimit rezulton se mosarsyetimet e vendimeve gjyqësore të sipërcituara jo vetëm janë të përsëritura dhe vazhduese, por rezultojnë të jenë

gjithashtu dhe të pajustificuara.

Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit, rezulton se çështjet civile familjare të gjykuara dhe për të cilat është marrë vendim nga ana e magistrates {...} për nga natyra e objektit të padisë apo të kërkesës si: zgjidhje martesë, lëshim urdhra të menjëhershëm mbrojtje dhe urdhra mbrojtje, pension ushqimor, njohje apo çnjohje atësie, nuk rezultojnë aspak të jenë të një niveli kompleks apo të vështirë.

Asnjë prej vendimeve të arsyetuara nuk rezulton të jetë voluminoz në atë përmasë që të justifikojë vonesën.

Referuar informacionit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se në periudhën 01.01.2020-10.09.2021 gjyqtarës {...} i kanë kaluar gjithsej 440 çështje (238 të mbartura, 144 të reja dhe 58 çështje gjatë periudhës së gatishmërisë) ndërsa ngarkesa mesatare e çështjeve në gjykim që kanë pasur gjyqtarët e seksionit familjar ka qenë 590 çështje për gjyqtar. Gjatë kësaj periudhe gjyqtarja {...} ka shpallur 182, ndërkohë numri mesatar i vendimeve të dhëna nga gjyqtarët e seksionit familjar është 318 vendime. Për rrjedhojë, nuk rezulton që magistratë {...} të ketë përballuar një ngarkesë më të madhe se gjyqtarët e tjerë të seksionit familjar, në raport me numrin e çështjeve për shqyrtim si dhe me numrin e vendimeve të shpallura, përkundrazi ajo ka qenë më e ulët.

Sa më sipër, vonesat e sipërcituara kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësisë. Kështu si rezultat i kësaj vonese, ankueses {...}, si dhe palëve të tjera në proceset gjyqësore, vendimet e të cilave janë dorëzuar me vonesë, u është ulur besimi në dhënien e drejtësisë, pasi një drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar, madje shtetasja {...} paraqiti edhe ankesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si rrjedhojë e cenimit të besimit se do të merrte në një kohë të arsyeshme një vendim të zbardhur, dhe se do t'i jepej mundësia për të ushtruar të drejtën kushtetuese të ankimit në një gjykatë më të lartë.

Vonesat e evidentuara kanë qenë të përsëritura e të vazhdueshme, siç rezultoi më sipër.

Nga të dhënat e marra gjatë hetimit provohet se gjyqtarja {...} ka një përvojë të gjatë në sistemin e drejtësisë, me një eksperiencë prej 2 vitesh si ndihmësgjyqtare dhe

prej 27 vite si gjyqtare, çfarë nënkupton eksperiencën e saj në zgjidhjen e çështjeve, në aftësitë e saj të fituara për shkak vjetërsie për të organizuar mendimin juridik në formën e vendimit të arsyetuar brenda një afati kohor të caktuar.

Nga sa më sipër provohet se nga ana e magjistrates {...} është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016.

Vonesa në arsyetimin e vendimit ka sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, pjesë përbërëse e të cilit është dhe vendimi i arsyetuar, si dhe vonesa në komunikimin e vendimit palëve ndërgjyqëse, paraqitjen e ankimit nga ana e tyre, si dhe shqyrtimin e këtij ankimi nga gjykata më e lartë, pjesë përbërëse e vetë procesit gjyqësor.

Në analizë të kriterit “mbi llojin dhe rrethanat e shkeljes” rezulton se nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, janë ndërmarrë veprime që përbëjnë një mospërbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të afateve procedurale civile të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke tejkaluar afatet tej çdo logjike, pavarësisht çështjeve me vështirësi të një niveli mesatar.

Në analizë të kriterit të “shkallës së fajësisë dhe motivi”, paraprakisht vlerësohet se faji si një element i përgjegjësisë disiplinore duke qenë se ka të bëjë me qëndrimin subjektiv të magjistratit ndaj kryerjes së shkeljes disiplinore si dhe pasojave të ardhura në lidhje me këtë shkelje disiplinore, nuk mund të provohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me prova dokumentare. Për të përcaktuar praninë (ekzistencën) dhe formën (shkallën) e fajit duhet të analizohen rast pas rasti rrethanat të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e shkeljes disiplinore. Për këtë arsye për të përcaktuar anën subjektive të kryerjes së shkeljes disiplinore nga ana magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë analizuar rrethanat e kryerjes së shkeljes disiplinore.

Ndërsa në analizë të kriterit “pasojat e shkeljes” në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor, rezulton se si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor është cenuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cenuar besimi i publikut të drejtësisë. Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, por ai gjen mbështetje te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve, sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të ligjit nr.

96/2016 “Për statusin”.

Në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 96/2016, është parashikuar se sjellja e magjistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimin e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

Në referim të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, gjykatat kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “vonesave të tepruara procedurale”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë edhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar.

Ndryshe nga vonesat në procesin gjyqësor, ku palët kanë ndikim shumë të shprehur, arsyetimi dhe dorëzimi i vendimit gjyqësor implikon vetëm gjyqtarin. Këtu gjyqtari është përballë vetvetes dhe përgjegjësia për vonesa është vetëm e tij. Gjyqtarët kanë detyrimin ligjor për respektimin e të drejtave të garantuara nga neni 6 i KEDNJ-së dhe legjislacioni i brendshëm lidhur me gjykimin e drejtë, si dhe është thelbësore të ruhet dhe të rritet besimi i qytetarëve tek gjykata dhe sistemi gjyqësor në përgjithësi

Në analizë të çështjes lidhur me “llojin e masës së disiplinore” paraprakisht vlerësohet se ligji nr. 96/2016 i referohet sanksionit disiplinor me termin “masë disiplinore”. Sipas parashikimeve të nenit 105 të ligjit, konstatohet se kjo dispozitë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, i cili kërkon që masa disiplinore të përcaktohet nga ligji, parashikon detyrimin për përzgjedhjen e masave disiplinore të parashikuara nga kjo dispozitë në një liste prej 6 masash (nga më e lehta te më e rënda), me qëllim që ndaj magjistratit të jepet ajo masë që është e domosdoshme dhe e dobishme për arritjen e qëllimit të procedimit disiplinor ndaj tij, në përputhje me shkeljen disiplinore që ka kryer,

në zbatim të parimit të drejtësisë, objektivitetit, individualizmit dhe proporcionalitetit.

Qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit për shkak të shkeljes disiplinore që ai ka kryer dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Në të njëjtën kohë masa disiplinore që caktohet ndaj magjistratit përmbush edhe dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Në rastin konkret për sa është analizuar më sipër, është arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates {...} të cilat përbëjnë shkelje disiplinore sipas nenit 102, pika 1, shkronja “d”, e ligjit nr. 96/2016, në bazë të kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115 përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111 i ligjit nr. 96/2016, të vendosë:

Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d”, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ftoj magjistraten {...} për të paraqitur pretendimet dhe parashtresat e veta në lidhje me këtë procedurë disiplinore.

{...}: Unë {...} e shkarkuar nga detyra si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Tiranë me vendimin nr. 437, datë 10.09.2021 të KPK-së, pasi u njoha me kërkesën për shkarkimin tim nga detyra parashtroj shpjegimin e mëposhtëm në lidhje me dorëzimin jashtë afatit ligjor të dosjes civile nr. {...} vendimi, datë 22.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse znj. {...} dhe të paditur {...}, me objekt: Shtimin e detyrimit ushqimor për fëmijë e mitur {...} të caktuar me vendimin nr. {...}, datë 29.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i cili ka marrë formë të prerë më datë 08.03.2019.

Në lidhje me dorëzimin jashtë afatit ligjor të dosjes në fjalë, si dhe të disa dosjeve të tjera të cituara, sqaroj se në muajin shkurt dhe në muajin mars 2021 gjendja ime shëndetësore ka qenë shumë e lënduar si pasojë e infektimit me virusin Covid-19. Gjatë kësaj periudhe kam marrë trajtim mjekësor në kushte shtëpie ku tre herë në ditë merrja serum dhe mjekimin e caktuar nga mjeku që ndoqi kurimin tim, në videocall me mjekun Gent Huti.

Theksoj se për një periudhë kohore prej 6 javësh kam qenë herë pas here në gjendje kritike për jetën dhe gjatë kësaj periudhe kam pasur nevojë pa ndërprerje për oksigjen. Ndërkohë në një moment frekuenca kardiake shkoi ... *(Preket emocionalisht znj. {...} dhe lë fjalën përgjysmë.)*

Më falni! Ju kërkoj shumë ndjesë!

... fakt ky i konstatuar në banesë nga shërbimi mjekësor i Spitalit Gjerman...

Ilir Rusi: E nderuar magjistrate!

Ju lutem, ndërprite pak parashtresën tuaj.

{...}: Unë falënderoj njëherë Zotin që më ka dhënë mundësinë që të jem sot përpara jush pasi në vitin 2021 u përballa me dy vetingje (mund të them kështu), vetingu i parë ishte ai i Perëndisë i cili më dha mundësinë që të jem edhe sot këtu, dhe vetingun e dytë, të cilin nuk e kalova dot (në shtator, brenda atij viti).

U ktheva më shpejt seç duhej në punë për shkak se ndihesha shumë përgjegjëse për gjyqet që shtyheshin dhe për të gjithë punën time. Megjithatë unë vendosa dhe u ktheva, pavarësisht se mbas 8 ditë fizioterapi (sepse nuk çohesha dot as në këmbë).

Ngarkesa, po ta shikoni, unë e kam marrë edhe nga sekretaria, ka qenë shumë, e kam ngarkuar jashtë mase gjithë kohën; edhe gjatë muajit gusht që ishte leja, pata urdhrat e menjëhershëm dhe vërtetimet e tyre, plus që më duheshe të siguroja dokumentacionin për vetingun që e kisha në datën 9 shtator. Megjithatë, jashtë mundësive të mua (më besoni për këtë), por vetëm ajo sedra ime, i përballova të gjitha. Më vjen shumë keq. Bile mua më vjen keq edhe për palën, {...}, e cila nuk besoj që ta ketë bërë ajo këtë, ka qenë e shtyrë nga të tjerë dhe më vjen shumë rëndë që flas kështu, sepse ajo ishte shumë e kënaqur, edhe për këtë e kisha sqaruar. Ngaqë unë kisha dalë jashtë për ta ndihmuar, gjithmonë brenda njerëzores dhe ligjit. Aty kisha vetëm ndryshim vendim dhe unë e orientova atë për të bërë, për të kërkuar edhe shtim objekti, për të kërkuar edhe lënien e fëmijës për rritje dhe edukim (meqenëse ishte një fëmijë i lindur jashtë martese) dhe kjo ishte. Prandaj dhe kanë zgjatur si seanca, për procedurë. Edhe plus që qëlloi...

Jam munduar jashtë mase shumë por pasojat i kisha shumë.. domethënë nga Covid-i kisha probleme me pulsën, edhe jashtë mundësive të mia, sinqerisht, kam punuar. Ndërsa këtë çështje, me sinqeritet, ndoshta ju keni edhe aksesin për ta parë edhe në kompjuter, unë isha ulur disa herë për ta punuar meqenëse kisha merak për apelin, prandaj u shty disa... Këto ishin. Unë nuk jam neglizhente fare, bile jam shumë meraklie për punën, e dua shumë. Unë e ndjej dhe e pranoj këtë vonesën, se është fakt, por kam qenë jashtë mundësive të mia. Më ka zgjatur me kohë, me kohë. Sinqerisht, më besoni për këtë.

Ilir Rusi: E nderuar zonja magjistrate!

Meqenëse në këtë seancë parashtrimet i keni me shkrim, mos kaloni në përsëritjen e tyre.

Ndonjë argument mbrojtës në mënyrë eksplicite keni, për sa parashtroni inspektori (përfaqësuesi përkatës)?

{...}: Ishte pamundësia ime.

Megjithatë, edhe deri në 12 të natës kam ndenjtur duke punuar, por ishte e pamundur. Aq mund të jepja.

Ridvan Hado: Pra ju pretendoni që keni qenë në pamundësi objektive për t'i bërë në afat për arsye të sëmundjes së Covid-it.

{...}: Deksimetrin e mbaja në sirtar poshtë tavolinës sepse edhe shpeshherë kërkoja falje dhe ngrihesha, dilja nga zyra se s'merrja frymë.

Ilir Rusi: Faleminderit për parashtresat!

Keni ndonjë pyetje të ndërsjellë, ju ndaj përfaqësuesit të Inspektorit apo përfaqësuesi i Inspektorit ndaj zonjës?

Anëtarët prezent në mbledhje kanë ndonjë pyetje, diskutim?

{...}: A mund të them diçka?

Ilir Rusi: Po!

{...}: Në lidhje me këtë humbjen e besimit. *(Preket emocionalisht znj. {...} dhe lë fjalën përgjysmë.)*

Ilir Rusi: Meqenëse nuk kanë pyetje anëtarët, ftoj përfaqësuesin e ILD-së dhe magjistraten {...} të largohen nga salla me qëllim që të vijojë Këshilli me diskutimet. Ju lutem prisni.

{...}: A mund të them diçka?

Më falni!

Kam punuar aq shumë, jo vetëm për këtë kohë, dhe kam zgjidhur aq shumë çështje, dhe tani që jam në shtëpi dhe kam mundësi që të kujtojë, janë jashtë imagjinatës njerëzore. Dhe shumë çështje janë normalizuar, aq shumë familje dhe aq shumë fëmijë, jeta e tyre ka ndryshuar. Dhe më vjen shumë keq që ndodhem këtu. *(Preket emocionalisht znj. {...}.)*

Ilir Rusi: Dakord! Në qoftë se nuk keni diçka për të shtuar më tej, mund të largoheni, që Këshilli të vazhdojë me diskutimet e mëtejshme.

{...}: Më falni!

Ju kërkohet shumë falje, por ndihem shumë... (*Preket emocionalisht znj. {...} dhe lë fjalën përgjysmë.*)

(*Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe gjyqtarja znj. {...}.*)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj seance dëgjimore të këtij procedimi disiplinor, fjala është për relatorin mbi qëndrimin dhe vijueshmërinë e mëtejshme të këtij procedimi disiplinor, duke marrë në konsideratë edhe parashtrirat dhe faktin e deritanishëm të ndodhur nga magjistratja {...}.

Gentiana Muçaj: Meqenëse magjistratja {...} me vendimin nr. 437, datë 10.09.2021 të KPK-së është shkarkuar nga detyra, dhe duke pasur parasysh praktikën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, unë propozoj pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e propozimit të bërë nga zonja Muçaj.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Meqenëse jemi në vijimësi të standardeve që ka mbajtur KLGJ-ja edhe në çështje të tjera të ngjashme ku interferon vendimmarrja dhe procesi i vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve me procesin disiplinor që nisen në KLGJ referuar kërkesave që paraqet Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Faleminderit! Jam edhe unë dakord me propozimin e bërë nga relatori.

Ilir Rusi: Dakord.

Ju lutem administratës të ftojë përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magistraten {...}, për t'i shprehur vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Rihyjnë në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe gjyqtarja znj. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vendimmarrjen e tij, vendosi:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437, datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magistrates znj. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

Faleminderit!

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe gjyqtarja znj. {...}.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës – seanca në orën 12:00. (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 15.02.2024.)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|--------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës z. *Klodian Kurushi*, i cili del nga salla e mbledhjes përpara trajtimit të saj.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.*
7. *Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
9. *{...}, përfaqësuese e ILD-së.*

RENDI I DITËS:

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates *znj. {...}* me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës – seanca në orën 12:00. (çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 15.02.2024.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje të sotme, vazhdojmë me pikën 2 të këtij rendi dite që ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates *znj. {...}* me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Durrës. Seanca është parashikuar të mbahet tani. Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 15.02.2024.

Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesen e ILD-së dhe nëse është paraqitur zonja {...} apo përfaqësuesja e saj.

(Hyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

Ilir Rusi: Në lidhje më tej me këtë seancë dëgjimore është paraqitur zonja {...}, me detyrë inspektore pranë Zyrës së ILD-së që është autorizuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për të përfaqësuar atë në këtë procedim disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Autorizimi mban numër {...} prot., datë 15.02.2024.

Ju bëj me dije që në vijim të këtij procedimi disiplinor kemi disponuar me njoftimet ndaj magjistrates {...} në adresat e veta fizike në lidhje me objektet përkatëse të deklaruara këtu me adresën e saj postare. Janë komunikuar aktet në lidhje me njoftimet e seancës dëgjimore dhe aktet e kërkuara prej saj në lidhje me dosjen hetimore, tashmë dosjen e procedimit disiplinor të filluar nga ana e ILD-së, i cili në këtë seancë përfaqësohet nga ana juaj, por nuk ka rezultuar ndonjë përgjigje qoftë nga posta elektronike apo nga posta ka ardhur me shënimet përkatëse që nuk janë marrë në dorëzim.

Ndodhur në këto rrethana, në vijueshmëri të ditëve, në datën 21 shkurt 2024, nr. {...} është protokolluar një kërkesë e zonjës {...}, nëpërmjet të cilës na ka paraqitur një prokurë përfaqësimi. Prokura ka nr. {...} kol, nr. {...} rep, datë 09.05.2023 nëpërmjet së cilës është shprehur që të gjitha njoftimet dhe aktet e dosjes hetimore t'i njoftohen avokates së caktuar me prokurë.

Avokatja e caktuar me prokurë është znj. {...}. Kemi disponuar në lidhje me njoftimet e akteve përkatëse, qoftë në lidhje me këtë procedim disiplinor me mbajtjen e kësaj seance dëgjimore të ditës së sotme datë 29 shkurt 2024, ora 12:00, gjithashtu kemi përcjellë edhe dosjen e kërkuar nga zonja {...} dhe në referim të këtyre komunikimeve në datë 23, është konfirmuar nga zonja {...} si referuese për të marrë aktet dhe njoftimet

përkatëse në këtë procedim disiplinor për mbajtjen e kësaj seance dëgjimore ditën e sotme. Gjithashtu në datë 27 shkurt, nëpërmjet postës, është konfirmuar edhe marrja e dosjes përkatëse. Ditën e djeshme datë 28 shkurt është paraqitur një kërkesë nga avokate {...} që për të siguruar një mbrojtje sa më efektive meqenëse referoi që në datë 27 shkurt ka marrë në disponim fizik dosjen hetimore, të cilës ia kemi përcjellë edhe nëpërmjet postës elektronike, ka kërkuar shtyrjen e seancës, por ka thënë me qëllimin që të marrë kohë për një mbrojtje më efektive, duke marrë në konsideratë edhe afatin brenda 15 ditëve t'i njoftohet. Këto akte i janë vënë në dispozicion. Gjithashtu, është fakt publik, që në datë 26 shkurt të këtij viti, nga ana e KPK-së është shpallur vendimi për shkarkimin e zonjës {...}. Jemi në këtë "status quo". Përfaqësuesit të Inspektorit i janë vënë në dispozicion këto çfarë përmenda unë, kërkesa, prokura, kërkesa për shtyrje, njëkohësisht dhe printimi nga interneti i njoftimit të KPK-së mbi shkarkimin e zonjës {...}.

Fjala për ju për të disponuar në raport me kompetencat që keni dhe për vijueshmërinë e këtij procedimi disiplinor.

Ndërkohë që zonja {...} nuk është paraqitur në këtë seancë dëgjimore, njëkohësisht edhe përfaqësuesja nëpërmjet asaj prokure, znj. {...} nuk është paraqitur. Pra prezent në këtë seancë dëgjimore është vetëm përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Parashtroj që zonja {...}, gjatë gjithë procesit të zhvillimit të fillimit të hetimit disiplinor me vendimin nr. 3408/1 datë 20.12.2023 deri në përfundim të këtij hetimi disiplinor është e njohur e ana e ILD-së me të gjitha aktet të cilat janë të konfirmuara me postë, jo postë elektronike, postën e zakonshme, dhe na është kthyer përgjigje si me rastin, si në rastin e njohjes së vendimit {...} datë 20.12.2023 ashtu edhe me të gjitha aktet e tjera deri në përfundimin e raportit dhe vendimin për mbylljen e hetimit disiplinor. Zonja {...} i është lënë një afat 3-javor për të sjellë parashtrësia pranë ILD-së. Ka konfirmuar marrjen e vendimit dhe të gjitha detyrimeve që ka dhe nuk ka paraqitur parashtrësia. Në momentin në seancën që ka filluar hetimi disiplinor për procedurën e fillimit të këtij pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, seancën e kaluar, zonja {...} ka sjellë disa parashtrime drejtuar KLGJ-së, parashtrime të cilat na janë vënë edhe ne si ILD në

dispozicion, ku ajo ka kërkuar një kopje të dosjes hetimore dhe të gjitha aktet për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së saj. Gjithashtu zonja {...} ka paraqitur edhe një kërkesë tjetër pranë KLGJ-së nr. {...} datë 15.02.2024 ku ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore gjithashtu, ka paraqitur dhe një kërkesë ku gjithashtu zonja {...} kërkon edhe pezullimin KLGJ-së një kërkesë me nr. {...}, datë 24.01.2024 ku ka kërkuar pezullimin e procedimit disiplinor të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me kërkesën nr. {...} prot, datë 18.01.2024, për fillimin e procedimit disiplinor me iniciativë ndaj veprimtarisë së magjistrates {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, deri në përfundim të gjyqimit në Gjykatën e Lartë.

E ndodhur para një fakti ku, zonja {...} si dhe mbrojtësja që ajo ka pretenduar në fund duke thënë, që me të gjitha këto akte do njihet, përfaqësuesja ligjore e caktuar nga ana e saj, duke bërë edhe një interpretim, duke bashkangjitur edhe vendime, një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë që ka kërkuar këtë pezullim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqet në lidhje me kërkesën që ka dorëzuar pranë KLGJ-së, ku ka paraqitur një prokurë 09.05.2023, gjithashtu edhe kërkesën për t'u njohur avokates së caktuar me prokurë, parashtrijmë që si zonja {...} ashtu edhe avokatja e saj, që nga data kur ne bëmë shtyrjen e seancës është njohur me të gjitha aktet. Fakti që KLGJ-ja i ka vënë në dispozicion këto akte, si dhe të gjithë procedurën e ILD-së që zonja {...} e ka pas të konfirmuar nga ILD-ja, mendoj që ne duhet të fillojmë të vazhdojmë me procesin për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...} me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Ka ndonjë pyetje apo diskutim të deritanishëm nga anëtarët prezent në mbledhje?

Po, zonja Plaku, fjala për ju.

Irena Plaku: Atëherë, me sa u relatua edhe nga ana juaj, zonja {...} është njohur me të gjitha aktet që i ka sjellë ILD-ja?

{...}: Zonja {...} duke filluar nga vendimi {...} datë 20.12.2023, ne i kemi

përshkruar edhe në relacion dhe në akte, është njohur me këtë vendim. Gjatë procesit që ne kemi zhvilluar me marrjen e të gjithë dokumentacionit nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit të Posaçëm, nga struktura e SPAK-ut në lidhje me ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, i kemi dërguar në fund kërkesën në bazë të ligjit që të paraqesë parashtrimet, të drejtat, detyrimet në lidhje me këtë proces. E ka konfirmuar marrjen e tyre dhe na është kthyer me postën zyrtare konfirmimi i tyre. Pas afatit 3-javor që ne kemi pritur konfirmimin e zonjës {...}, ne kemi filluar përgatitjen e raportit dhe vendimin për përfundimin e procedurës. Me vendimin për përfundimin e procedurës bashkëngjitur raportit, zonjës {...} i ka vajtur ky raport, i cili mbasi është konfirmuar, ne kemi sjellë pranë KLGJ-së.

Irena Plaku: Ok! Dakord!

Ilir Rusi: Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Luli!

Fatmira Luli: Në lidhje me adresën që keni komunikuar ju, kush është adresa zyrtare që ajo i është përgjigjur komunikimeve tuaja dhe me këtë raportin dhe vendimin, ka marrë edhe dokumentacionin që ka shërbyer për...?

{...}: Në lidhje me përgjigjen, me mbylljen e raportit dhe të gjithë dokumentacionit zonja {...} është njohur me aktet. Adresa zyrtare është adresa që ajo ka paraqitur, ka dhënë edhe konfirmimin dhe është adresa e komunikimeve të banesës së saj me gjykatën e posaçme, me Gjykatën e Posaçme të Apelit, me SPAK-un në lidhje me ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë dhe nga ky moment të gjitha aktet i kanë vajtur në atë adresë. Konfirmimet janë në dosjen origjinale që ne i kemi përcjellë KLGJ-së. Janë të gjitha të firmosura nga ana e saj dhe fakti që ne kemi pritur tre javë në lidhje me parashtrirat e zonjës {...}, kemi filluar pastaj procedurën ngaqë ajo nuk paraqiti parashtrirë, kemi filluar procedurën për përfundimin e hetimit disiplinor. Edhe në të njëjtën adresë i kemi dërguar raportin dhe vendimin për mbylljen e hetimit disiplinor, e

cila na është konfirmuar nga posta zyrtare. Mbas kësaj ne kemi dërguar të gjitha aktet KLGJ-së.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

(Nuk ka pyetje.)

Ndërkohë, sikundër kemi vepruar edhe në mbledhjen e datës 15.02.2024, zoti Kurushi përgjatë shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, për shkak të një konflikti interesi të deklaruar nga ai vetë, nuk është prezent në shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Meqenëse nuk keni pyetje të tjera, ftoj përfaqësuesen e ILD-së të largohet, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutime dhe do të rinjoftoheni përsëri.

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj seance dëgjimore, ftoj anëtarët nëse kanë ndonjë diskutim, duke dëgjuar edhe parashtrirat e përfaqësueses së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe duke marrë në konsideratë dhe vlerësim dokumentacionin e paraqitur deri më tani nga unë si relator.

Po, zonja Plaku, fjala për ju.

Irena Plaku: Pasi dëgjova edhe përfaqësuesen e ILD-së, vlerësoj në radhë të parë sa i përket njoftimit që ne kemi bërë për sa i përket dokumentacionit, zonja {...} është njohur me të gjithë dokumentacionin që nga ILD-ja dhe e vetmja provë që na është paraqitur nga ana e saj është vendimi gjyqësor i Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe nuk ka prova të tjera, kështu që unë nuk mendoj që ne duhet t'i lëmë kohë edhe një herë për t'u njohur me provat. Megjithatë pasur parasysh edhe aktin e përfaqësimit të paraqitur nga ana e zonjës {...} e cila ka pretenduar që përfaqësohej nga avokate {...}, referuar tagrave të përfaqësimit, vlerësoj se ne duhet ta shtyjmë edhe një herë seancën e sotme dëgjimore për t'i dhënë edhe një herë mundësi zonjës {...} për t'u paraqitur për t'u

mbrojtur efektivisht pranë KLGJ-së lidhur me këtë procedim disiplinor, pasi nga tagrat e përfaqësimit nuk vlerësoj se përfaqësuesja e zgjedhur prej saj ka mundësi që të përfaqësojë në këtë procedim disiplinor. Nga tagrat e përfaqësimit rezulton se ka vetëm të drejtat të tërheqë dokumentacionin dhe lidhet me procesin penal. Për sa më sipër unë vlerësoj se duhet ta shtyjme duke i dhënë edhe një herë mundësi për t'u paraqitur vetë apo nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej saj me tagra të përcaktuara qartë lidhur me këtë procedim disiplinor. Por vlerësoj që kjo duhet të jetë shtyrja e fundit dhe jo të kemi më shkresa të tilla për dërgime aktesh, pasi me aktet është njohur efektivisht, për sa kohë që ndër të tjera zonja {...} ka paraqitur edhe kërkesa të vazhdueshme, çka do të thotë që vetë ka qenë aktive për t'u njohur me këtë procedim disiplinor, duke u paraqitur pranë Këshillit apo nëpërmjet personave të tjerë për të paraqitur kërkesat e saj për shtyrjen apo kërkesa të ndryshme të cilat janë paraqitur. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime apo propozime të tjera?

Përsëri, në vijim të këtij procedimi, po zonja Plaku çfarë keni për të shtuar?

Irena Plaku: Atëherë, në rast se pranohet kërkesa për shtyrjen e kësaj seance, propozoj që të kemi një datë të afërt, pasur parasysh edhe procedimet e tjera të cilat kemi në shqyrtim, propozoj që të jetë data 13 mars, ora 10:00. Ky është propozimi im.

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse nuk ka propozime të tjera, më lejoni për ta perifrastuar. Pra propozimi është shtyrja e kësaj seance dëgjimore në lidhje me magjistraten {...} për t'i dhënë mundësi për një mbrojtje sa më efektive, gjithashtu për t'i dhënë mundësi për t'u paraqitur vetë dhe në rast se nuk paraqitet vetë, duke autorizuar një person për ta përfaqësuar me një prokurë të posaçme për këtë procedim disiplinor të filluar ndaj saj, me kërkesë të ILD-së, dhe që po zhvillohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me procedimin përkatës. Në eventualitet të vendimmarrjes për t'u shtyrë, propozoj që seanca e radhës dëgjimore të jetë në datë 13 mars, ora 10:00.

Atëherë, vazhdojmë me votimin përkatës të propozimit të bërë nga zonja Plaku, të

perifrazuar nga ana ime.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesen e ILD-së.

(Rihyn në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

Ilir Rusi: Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

Për t'i dhënë mundësi për një mbrojtje sa më efektive magistrates znj. {...}, të shtyjë këtë seancë dëgjimore, për të mundësuar paraqitjen personalisht vetë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me këtë procedim të zonjës {...}, në rast të kundërt të autorizohet nëpërmjet një prokure një përfaqësues/se, me një prokurë të posaçme, në lidhje me përfaqësimin e saj në këtë procedim disiplinor pranë KLGJ-së të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Seanca tjetër dëgjimore u vendos më datë 13 mars, ora 10:00.

Mund të largoheni. Faleminderit!

(Del nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |

9. *Yllka Rupa* (anëtare)

10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Baisa Sefa, Kwshilltare pranw Kabinetit tw Kryetares sw Kwshillit tw Lartw Gjyqwsor.*

4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*

6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.*

7. *Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.*

8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

(Rihyn në sallën e mbledhjes zoti Kurushi.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”

në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë!

Pa humbur kohë po prezantoj relacionin që i bashkëngjitet projektvendimit “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 104, datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, vendosi në atë kohë:

Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për dy pozicione të lira.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues është dy javë nga dita e shpalljes së këtij vendim.

Brenda afatit të kandidimit për komandimin në pozicionet si më lart kandidoi edhe znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë.

Në përfundim të procedurës së komandimit, sipas përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit nr. 104, datë 05.07.2019, pas vlerësimit të plotësimin të kriterëve të komandimit, me propozim të Komisionit të

Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 24, datë 20.01.2020 vendosi:

“1. Komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon më datë 02.03.2020.

3. Përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarës {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë, me përjashtim të çështjeve urgjente”.

Në përfundim të afatit të komandimit, të përcaktuar në vendimin e cituar më lart, Këshilli me vendimin nr. 81, datë 02.03.2022 vendosi: “1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dyvjeçar. 2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 02.03.2022.”

Aktualisht afati i periudhës së komandimit të znj. {...} është duke përfunduar, konkretisht më datë 02.03.2024 dhe nuk rezulton të jetë shfaqur vullneti i saj për përsëritje të komandimit.

II. Propozimi i Komisionit

Për sa më sipër, rezulton të jetë me vend për të vendosur bashkërisht deklarin e përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës {...} në fund të afatit të komandimit të caktuar, sipas vendimit të Këshillit nr. 81, datë 02.03.2022 pikërisht më datë 03.02.2024, sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenit 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar.”.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

III. Struktura e Projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 02.03.2024, referuar vendimit të Këshillit nr. 81, datë 02.03.2022.

Në pikën 2 të përcaktohet kthimi në pozicionin e mëparshëm, një e drejtë kjo referuar pikës 4, të nenit 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këtë dispozitë përcaktohet se: “4. Magjistrati i ka të drejtë që pas periudhës të komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj”.

Këshilli me vendimin nr. 43, datë 31.01.2024, ndër të tjera ka vendosur: “Transferimin e gjyqtares znj. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ku është caktuar në mënyrë të përhershme.”. Për sa më lart propozohet kthimi i saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe gjykatës respektive ku ka caktimin si gjyqtare, konkretisht: Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 02.03.2024.

2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.**
- 7. Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Irena Plaku*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores, *znj. Plaku*.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju paraqes në mënyrë të përmbledhur relacionin mbi miratimin e kërkesës për dhënie leje të papaguar për arsye familjare.

Më datë 30.01.2024 znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka paraqitur “Kërkesë për leje të papaguar për periudhë: 3 prill 2024 – 3 qershor 2024”, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 30.01.2024.

Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron faktin se është gjyqtare pranë kësaj gjykate dhe ka dy fëmijë binjakë të lindur më datë 22 prill 2023 dhe pasur parasysh moshën e tyre, kërkon që të ketë edhe një periudhë tjetër dymujore shtesë për t’u kujdesur për ta, për sa kohë që nuk ka asnjë familjar për t’i ofruar asaj mbështetjen në mënyrë që fëmijët të mos t’i dërgojë në institucionet për përkujdesje. Konkretisht magjistratja në kërkesë ka parashtruar kërkesën referuar nenit 24/3 të ligjit nr. 96/2016: “Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. [...]”

Me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtarës {...}, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 72, datë 20.02.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, u kërkuar depozitimi pranë Këshillit të mendimit të Zv/Kryetarit të gjykatës dhe u kërkuar nga kancelari i gjykatës, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve.

Zv/Kryetari i Gjykatës, nëpërmjet e-mailit të datës 13.02.2024 ka përcjellë mendimin e tij, duke e lënë në çmim të KLGJ-së dhënien e lejes së papaguar duke relatuar faktin se në dhomën penale, për vitin 2023 kanë qenë 21 gjyqtarë, të cilët kanë pasur një mesatare prej 850 çështjesh në gjykim dhe kjo situatë vjen si pasojë e numrit të vogël të gjyqtarëve në këtë dhomë, si dhe volumit të madh të çështjeve.

Gjithashtu duke pasur parasysh organikën e gjykatës, ka kërkuar që të plotësohen këto vende vakante.

Sa i përket ngarkesës aktuale të gjyqtarëve të fushës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kancelari i gjykatës nëpërmjet postës elektronike më datë 07.02.2024, ka përcjellë këto të dhëna:

Gjyqtarja nuk ka çështje në shqyrtim, pasi ka përfituar nga e drejta e barrë lindjes më datë 18.04.2023; Ngarkesa mesatare aktuale e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është 204 çështje për gjyqtar.

Nga informacioni i marrë nga dosja personale e gjyqtares, rezulton se kjo e fundit është caktuar si gjyqtare me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 19.07.2019. Me vendimin e datës 30.07.2019 është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Me vendim nr. 433, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është komanduar në Gjykatën e Lartë për një periudhë 3-vjeçare. Me vendim e datës 31.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pavarësisht lëndës, nga përmbajtja e kërkesës për leje kemi vlerësuar se jemi përpara kërkesës për leje për arsye familjare, duke qenë se vetë gjyqtarja në kërkesë citon nenin 24/3 të ligjit 96/2016 dhe i referohet të drejtës së saj për të kërkuar leje për arsye familjare.

Lidhur me lejen e papaguar, në nenin 24 të Ligjit nr.96/2016, parashikohet se, magjistrati mund të përfitojë leje prindërore ose pushime të tjera. Në këtë nen parashikohen disa kriteret për dhënien e lejes së papaguar nga Këshilli dhe njëkohësisht parashikohet se: “Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.”. Për këtë qëllim është miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor vendimi nr.72, datë 20.05.2019.

Lidhur me kushtet që ka parashikuar ligji dhe vendimi nr. 72 i Këshillit, kemi tre lloj lejesh:

Leja prindërore, leje me qëllim kualifikimi e specializimi në një institucion trajnimi dhe leje për arsye familjare ose shëndetësore.

Referuar kërkesës së zonjës {...} e cila është vlerësuar se jemi përpara kërkesës për dhënie leje familjare, lidhur me kushtet e dhënies së lejes, në vendim parashikohet se leja për arsye familjare jepet nga 30 ditë deri në 2 vjet. Gjyqtari paraqet kërkesë me shkrim, në këtë rast, të paktën 30 ditë përpara se të fillojë kjo leje. Në këtë rast zonja {...} e ka paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar.

Kërkesa trajtohet nga Këshilli, i cili brenda 7 ditëve i përcjellë Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit;

Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por në total jo më shumë se 2 vjet.

Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.

Në rastin konkret, siç e theksuam, janë plotësuar kriteret, konkretisht:

Kërkesa është për një afat 2 muaj, nga data 03.04.2024 – 03.06.2024; Kërkesa është paraqitur përpara 30 ditëve; Kërkesa është për arsye familjare, sipas përcaktimeve të nenit 24/3 të ligjit 96/2016; Gjithashtu është paraqitur mendimi me shkrim i zëvendëskryetarit të gjykatës, i cili e ka lënë në vlerësim të Këshillit miratimin ose jo të kësaj leje.

Për sa më sipër, nga Komisioni vlerësohet se:

- kërkesa e gjyqtares për leje të papaguar për arsye familjare, përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24, të ligjit nr. 96/2016 dhe vendimin nr.72, të KLGJ-së;

- arsyeja për këtë leje, e paraqitur nga gjyqtarja, është e pranueshme, pasi lidhet drejtpërdrejtë me të drejtën e saj për jetë familjare. Kjo e drejtë i garantohet asaj, si çdo shtetasi, nga neni 8 i Konventës dhe neni 53 i Kushtetutës;

- mungesa e gjyqtares në ushtrimin e funksionit të tij pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak të ngarkesës që ka, nuk vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.

Sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat gjyqtarja ka në shqyrtim, siç u theksua më sipër, gjyqtarja nuk ka në shqyrtim asnjë çështje për sa kohë kjo e fundit ka qenë me leje barrë lindje.

Referuar sa më sipër Komisioni i propozon mbledhjes plenare:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një periudhë dymujore, nga data 03.04.2024 – 03.06.2024.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe gjykatës.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Gjithashtu është edhe publikimi i vendimit në faqen zyrtare të Këshillit.
Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimin. Kam vetëm një koment jashtë atij propozimi. Më bëri përshtypje përgjigjja që ka dhënë zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku evidenton faktin e ngarkesës së madhe që kanë gjyqtarët e dhomës penale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2023 që janë gjithsej mesatarisht 850 çështje në dorë dhe përtej objektit të përgjigjes ai ka kaluar në një kërkesë konkrete, që të shtohet numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Atëherë, thjesht për informacion, bëj me dije, ndoshta dhe jo ne këtu, por të gjithë të tjerët që janë të interesuar, jo më larg, por të martës që kaloi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur vakanca të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka hapur gjithsej 9 vende, prej të cilave 7 pozicione janë në fushën civile dhe 2 të tjera janë në fushën penale. Për më tej ne po javën që kaloi kemi dërguar edhe një gjyqtar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe e dimë që kjo gjykatë është në nevojë dhe e kemi në vëmendje edhe këtë shqetësim të

ngritur nga zëvendëskryetari i gjykatës. Faleminderit!

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për dhënie leje të papaguar gjyqtares {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për një periudhë dymujore, nga data 03.04.2024 – 03.06.2024.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.**
- 7. Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore *znj. Fatmira Luli*).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 5 të tij, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores, *znj. Luli*.

Fatmira Luli: Faleminderit zoti drejtues i seancës!

Z. {...} është kandidat për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 157, datë 04.04.2023, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në Provimin e Pranimit në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023–2024, profili “ndihmës ligjor”.

Kandidati ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla në listën e renditjes së kandidatëve fitues në Programin e Formimit Fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2023–2024.

Në funksion të verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet e informacioneve, me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, është vendosur fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023–2024.

Nga kandidati janë marrë të gjitha deklaratimet. Ka plotësuar në kohë brenda afateve ligjore në rrugë elektronike për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, për caktimin e relatorit, të drejtën për të kërkuar përjashtimin. Njëkohësisht u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularëve deklarues për adresën postare elektronike, kontaktet telefonike.

Lidhur me qëllimet e procedurës së verifikimit, brenda këtyre afateve ligjore, plotësoi të gjithë dokumentacionin përkatës.

Mbasi në Këshill kishin ardhur të gjitha përgjigjet e institucioneve, z. {...}, me shkresën datë 01.02.2024, drejtuar Këshillit, ka bërë me dije tërheqjen për shkak të arsyeve personale nga vazhdimi i procedurave të mëtejshme në lidhje me pozicionin e ndihmësit ligjor.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 09.02.2024, Shkolla e Magjistraturës ka informuar Këshillin se z. {...}, me kërkesën e tij, të depozituar me nr. {...} prot., datë 31.01.2024, i është drejtuar Shkollës së Magjistraturës për heqjen dorë nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023–2024.

Në këto kushte, sipas vendimit nr. 424/2020 parashikohet se qëllimi i këtij

vendimi është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit gjatë rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përcaktuara në këtë rregullore. Në bazë të pikës 2 të këtij vendimi parashikohen procedurat edhe për kandidatin fitues në provimin e pranimit për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit.

Neni 29, i Rregullores së Brendshme të Shkollës parashikohet detyrimi që kandidatët fitues nënshkruajnë marrëveshjen e regjistrimit, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit përgjatë Programit të Formimit Fillestar. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kandidati konsiderohet i regjistruar në Shkollën e Magjistraturës. Refuzimi për nënshkrimin e marrëveshjes dhe heqja dorë nga lista e fituesve për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, e lë objektin e këtij verifikimi pa qëllimin për të cilën është nisur.

Vlerësimi mbi gjendjen.

Tërheqja e z. {...} nga e drejta për të ndjekur Programin e Formimit Fillestar, ka sjellë si pasojë rënien e shkakut për të cilën kjo procedurë ka filluar dhe për këtë arsye, është vlerësuar se nuk ekziston më qëllimi për të cilin ka filluar procedura e verifikimit.

Deklarimi i përfunduar i procedurës, nuk zgjidh themelin e çështjes, fakt i cili nuk pengon fillimin kryesisht të procedurës me kërkesë të palës së interesuar, derisa nuk është marrë një vendim dhe s'kanë kaluar afatet ligjore.

Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit, në mbledhjen e datës 16 shkurt 2024, duke konsideruar në përputhje me ligjin procedurën e verifikimit të pasurisë, vendosi kalimin e kësaj çështjeje në seancë plenare për të vendosur deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për z. {...}, të filluar me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet z. {...}, sipas ligjit nr. 115/2016 (neni 98).

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të z. {...}, të filluar me vendimin nr. 473, datë 07.09.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes të statusit të kandidatit fitues për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.*
7. *Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 6 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë

funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Deri më datë 15.02.2024, pranë KLGJ-së, janë paraqitur për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas të dhënave të mëposhtme: Bëhet fjalë për dy çështje administrative (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Në lidhje me kërkesat si më sipër, Gjykata Administrative e Apelit me shkresën nr. {...} dhe {...} prot., datë 22.12.2023 ka bërë me dije se (është rasti kur ne kemi dërguar nëpërmjet skemës së delegimit gjyqtarë në Gjykatën Administrative të Apelit): “...Në kushtet kur ka gjyqtarë efektivë për gjykimin e çështjeve administrative, kërkojnë revokimin e kërkesës, duke vlerësuar se çështja duhet ti nënshtrohet procedurave të shortit për plotësimin e trupit gjykues.”. Pra Gjykata Administrative e Apelit ka mundësi vetë ta plotësojë trupin gjykues me gjyqtarët që kanë ardhur nëpërmjet skemës së delegimit.

Për rrjedhojë, nevoja për kërkesën si më lart të Gjykatës Administrative e Apelit, aktualisht nuk ekziston më, pasi nevoja për caktimin e gjyqtarëve në çështjet konkrete është plotësuar përmes gjyqtarëve të skemës së delegimit të cilët shërbejnë pranë kësaj gjykate.

Në këto kushte, kërkesa si më lart e Gjykatës Administrative e Apelit tashmë ka mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ.”.

Referuar nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative rezulton se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

Kurse sipas nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016, “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.”.

Propozimi: Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative e Apelit si vijon:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 12.01.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditës {...}, e paditur: Këshilli i Lartë Gjyqësor me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”, çështje kjo e veçuar sipas vendimit datë 01.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 09.11.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse Shoqëria “{...}” sh.p.k., palë të paditur Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë me objekt: “Shfuqizimin e urdhrit nr. {...}, datë 13.12.2018, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin...”.

Këto janë propozimet.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Të deklarojë të përfunduar, pa një vendim përfundimtar, shqyrtimin e kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit, për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, si më poshtë:

1. Kërkesës nr. {...} prot., datë 12.01.2023, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditës {...}, e paditur: Këshilli i Lartë Gjyqësor me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”, çështje kjo e veçuar sipas vendimit datë 01.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Kërkesës nr. {...} prot., datë 09.11.2022, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore me palë: paditëse Shoqëria “{...}” sh.p.k., palë të paditur Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë me objekt: “Shfuqizimin e urdhrit nr. {...}, datë 13.12.2018, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin...”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të

Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

7.1 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

7.2 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

7.3 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

7.4 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)

- | | |
|--------------------------|------------------|
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.*
- 7. Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

7.1 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

7.2 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

7.3 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

7.4 Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 7, shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, vijojnë përpjekjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të përmirësuar punën e gjykatave të konsideruara në nevojë, që janë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës dhe Tiranë. Në këtë kuadër, me vendimet nr.87, nr. 88, nr.89, nr.90, datë 20.02.2024 është proceduar në vijimin e skemës së transferimit në këto gjykata dhe për këtë qëllim është ngarkuar KZHK-ja t’u drejtohet gjyqtarëve të cilën e kanë një mandat në këtë skemë transferimi, të cilën konkretisht janë z. {...}, z. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, të cilët janë ftuar për të dhënë përsëri pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm. Brenda datës së vendimmarrjes së Këshillit, KZHK-ja i është drejtuar të gjithë gjyqtarëve, duke marrë përkatësisht në mënyrë individuale nga secili prej tyre pëlqimin për vijimin e procedurës së transferimit dhe njëkohësisht i është drejtuar kryetarëve të gjykatave në respektim të nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 si edhe nenit 8 të vendimit nr.23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe

procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, ku i është kërkuar opinion në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës dhe Tiranë; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Në kuadër të transparencës ja i detyruar t’i riprodhoj opinionet përkatëse të secilit prej kryetarëve (zëvendëskryetarëve në detyrë) dhe po e filloj nga ai i Lezhës i cili thotë: “Bazuar në kërkesën tuaj, për dhënien e një informacioni dhe mendimi, lidhur me kërkesën e ardhur nga gjyqtari z. {...}, si dhe nisjes së procedurës për transferim të përkohshëm deri në një vit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në bazë të nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 si edhe nenit 8 të vendimit nr.23, datë 07.02.2019 po ju dërgojmë informacion në lidhje me: ngarkesën e gjykatës, ku aktualisht janë në shqyrtim me përfaqësi 1.711 çështje civile dhe penale, bazuar në statistikat dhe raportimin më të fundit tremujor 01.10.2023 – 31.12.2023; nuk krijohen pasoja dhe nuk dëmtohet funksionaliteti apo veprimtaria e gjykatës nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në kushtet kur në organikën e kësaj gjykate vazhdojnë të ushtrojnë detyrën 7 gjyqtarë efektivisht dhe 1 gjyqtare konkretisht gjyqtarja Edlira Çota, përfundon lejen e marrë 3-mujore më 31 mars 2024;

Në përfundim, propozoj afatin 1-vjeçar për transferim të përkohshëm të gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në vijim.”.

Gjithashtu është administruar edhe opinionin e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, i cili shprehet se: “Në këtë gjykatë ushtrojnë efektivisht funksionin 6 (gjashtë) gjyqtarë. Në mënyrë tabelare ka paraqitur ngarkesën individuale të secilit gjyqtar.

Vlerësoj se aktualisht ngarkesa në punë është relativisht e lartë, por e shkaktuar nga fakti se si pasojë e procesit të vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë ndryshuar trupat gjyqësore në vazhdimësi duke sjellë edhe mbartjen e çështjeve gjyqësore të vjetra. Njëkohësisht ka pasur ndikim situata e pandemisë së COVID-19, si

dhe bojkoti i seancave gjyqësore nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në muajin korrik 2022. Referuar edhe raportimeve periodike që janë përpiluar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, numri i çështjeve të themelit me palë kundërshtare ka një tendencë të lehtë në ulje dhe duke marrë në referencë edhe Hartën e re Gjyqësore, sipas së cilës edhe fshatrat që i përkasin Bashkisë Himarë, por që deri në këtë moment kanë qenë në kompetencën lëndore dhe territoriale e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, do të jenë kompetencë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, numri i çështjeve do të ketë ulje të mëtejshme. Në lidhje me faktin nëse cenohet funksionaliteti i gjykatës, vlerësohet se lëvizja e një gjyqtari nuk cenon funksionalitetin, duke pasur parasysh se aktualisht ushtrojnë funksionin gjashtë gjyqtar dhe situata po shkon drejt normalizimit. Në lidhje me periudhën maksimale të transferimit të përkohshëm vlerësohet se periudha maksimale prej 1 viti është e arsyeshme.”.

Më tej zëvendëskryetarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka dërguar informacionin e kërkuar si vijon: “Nga ana Juaj është kërkuar mendim në lidhje me funksionalitetin e Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në rastin e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve z. {...}, znj. {...}, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ju bëj me dije se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht e ka organikën me 21 gjyqtarë, por aktualisht ushtrojnë funksionet pranë kësaj gjykatë 14 gjyqtarë. Zonja {...} është me leje të papaguar nga KLGJ. Me vendimin nr.582 datë 18.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë emëruar 6 gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (duke cituar në mënyrë nominale këta gjyqtarë) dhe duke paraqitur në formë tabelare ngarkesën individuale të secilit gjyqtar ku në total kjo gjykatë përballon një ngarkesë prej 2.771 çështjesh.

Sa më sipër, duke mbajtur parasysh edhe arsyen për hapjen e pozicioneve për transferim të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhoma civile dhe penale), periudhën e transferimit të përcaktuar në vendimin e KLGJ, si dhe rrethanat profesionale dhe familjare të gjyqtarëve, mendoj se transferimi i përkohshëm i tyre nga ana e Këshillit, nuk do të sillte cenimin e funksionalitetit të

Gjykatës.”.

Këto ishin pak a shumë opinionet pozitive për vijimin e transferimit të përkohshëm. Kështu që në këtë kuadër, duke parë ngarkesën aktuale të gjyqtarëve që kanë shprehur pëlqimin pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Tiranë, marrë në konsideratë jo vetëm organikën aktuale por edhe numrin e madh të çështjeve, ekzistencën e pozicioneve të lira të përkohshëm në të, si dhe ngarkesën aktuale Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Fier dhe Sarandë ku ata kanë caktimin në mënyrë të përhershme, bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimet konform neneve 4 dhe 8 të vendimit nr.23, datë 07.02.2019:

Të miratojë përsëritjen e transferimit të përkohshëm për gjyqtarët z. {...} dhe z. {...}, deri në periudhën 13.03.2025, për z. {...} dhe znj. {...}, për periudhën deri më 13.03.2025.

Gjithashtu është parashikuar edhe njoftimi individual i këtyre gjyqtarëve dhe gjykatave ku ata janë të komanduar në skemën e transferimit të përkohshëm dhe njëkohësisht ku kanë qenë të caktuar në mënyrë të përhershme. Për secilin prej tyre është përgatitur projektvendim i veçantë, me këtë përmbajtje të cilën ju ftoj ta miratojmë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Ilir Rusi: Atëherë, kalojmë në votimin e projektvendimeve në mënyrë individuale.

Fillimisht hedhim në votim projektvendimin për magistratin zotin {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në 13.03.2025.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 13.03.2024.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin e projektvendimit për gjyqtarin {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një periudhë deri në 13.03.2025.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 13.03.2024.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin e projektvendimit për gjyqtarin {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në 13.03.2025.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 13.03.2024.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me votimin e projektvendimit për gjyqtaren {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Gjyqtarja {...}, aktualisht gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në 13.03.2025.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 13.03.2024.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...}, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër” / “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 04/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ilir Rusi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.**
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI.**
- 7. Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër” / “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 04/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ilir Rusi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e

projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”/ “Për mbylljen e procedimit disiplinor nr. 04/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...} me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, për të cilën është përgatitur relacioni përkatës dhe relator jam unë Ilir Rusi.

Relacion “Mbi vijueshmërinë e procedurës së shqyrtimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që i përket procedimit disiplinor nr. 4/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër”, me të cilin jeni njohur.

Më datë 19.02.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. {...} prot., datë 16.02.2024, ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën me objekt: Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga nenet 102, pika 1, shkronja “dh” dhe 102, pika 2, shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit z. {...} të parashikuar nga neni 111 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me vendimin nr.95, datë 23.02.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur të caktojë si relator të çështjes, z. Ilir Rusi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor.

Në vijim të relacionit janë paraqitur faktet që kanë të bëjnë me fillimin e hetimit disiplinor, zgjatjen e hetimit disiplinor, përfundimin e hetimit disiplinor dhe në fund fillimin e procedimit disiplinor.

Bazuar në nenin 31 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë

Gjyqësor”, në cilësinë e Relatorit të çështjes, u kryen verifikime mbi ekzistencën e rasteve të parashikuara nga neni 139 të Ligjit “Për Statusin”, të cilat çojnë Këshillin drejt Vendimmarrjes për mbylljen e procedimit disiplinor, pa zhvilluar seancë dëgjimore. Këto raste janë të parashikuara në mënyrë shteruese në ligj, si vijon:

Nëse shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të Ligjit “Për statusin”. Sipas kësaj dispozite përcaktohet se shkeljet disiplinore parashkruhen brenda pesë vjetëve. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.

Sipas të dhënave në dosjen hetimore dhe në raportin e hetimit, rezulton se referuar vendimeve gjyqësore të dhëna nga magjistrati, objekt të procedimit disiplinor, si dhe referuar datës së vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e hetimit disiplinor, rezulton se hetimi disiplinor është filluar brenda afatit të parashkrimit.

Nëse çështja ka qenë objekt i një procedimi disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezulton se shkeljet e pretenduara, të kenë qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor, të zgjidhur me vendim të formës së prerë.

Nëse ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja “ç” dhe “d” të Ligjit “Për Statusin”. Sipas këtij neni parashikohet se Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse provohet se rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: (i) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të Ligjit “Për statusin” ose (ii) nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të Ligjit “Për statusin” ose (iii) magjistrati ka vdekur. Sa referuar, konstatohet se nga verifikimet e kryera dhe nga të dhënat e dosjes hetimore, nuk rezultoi e provuar ekzistenca e një prej këtyre shkaqeve ligjore.

Nëse raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar raporti i hetimit i përgatitur nga Inspektorët përgjegjës, dhe miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e ligjit “Për statusin”.

Referuar këtij parashikimi ligjor, arrihet në përfundimin se raporti i hetimit është

depozituar i arsyetuar dhe plotëson të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë ligjore.

Sa i përket shqyrtimit nga Komisioni Disiplinor.

Në mbledhjen e datës 28.02.2024, Komisioni Disiplinor pasi dëgjoi relatorin e çështjes, si dhe u njoh me relacionin e hartuar nga ana e tij, si dhe me aktet e ndodhura në dosjen hetimore vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe caktimin e datës dhe orës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, ose mbylljen e procedimit disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Sa u parashtrua, në kushtet kur nuk ndodhemi në asnjë nga rastet e parashikuara në ligj për mbylljen e procedimit disiplinor, në cilësinë e relatorit, i propozoj mbledhjes plenare kalimin e çështjes për shqyrtim të mëtejshëm në seancë dëgjimore, e cila, si rregull, duhet të zhvillohet brenda 1 (një) muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra nga data 19.02.2024. Në caktimin e datës së seancës dëgjimore, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë afatin 15-ditor të njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të nenit 138 të ligjit “Për statusin”.

Në eventualitet këto janë dy momente, nëse do mbyllet ky procesin disiplinor pa seancë dëgjimore apo do kalojë në seancë dëgjimore.

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime lidhur me propozimin tim si relator për të kaluar në seancë, atëherë propozoj që seanca dëgjimore të jetë në datën 19 mars 2024, ditë e martë, ora 11:00.

Ka diskutime në lidhje me mbajtjen e seancës?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e dy propozimeve, së pari për mbajtjen e seancës dhe së dyti për datën dhe orën e saj.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Këshilli vendosi që seanca dëgjimore në lidhje me këtë procedim disiplinor të zhvillohet në datë 19 mars 2024, ditë e martë, ora 11:00. Të njoftohet magjistrati dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë për këtë seancë dëgjimore.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.02.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin para afatit të komandimit të z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:18 dhe mbaroi në orën 14:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 10. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Oltta Lolo, eksperte të EWMI.*
7. *Arben Lila dhe Enkeleida Pulaj, ekspertë të EU4Justice.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin para afatit të komandimit të z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje po vazhdojmë me pikën e fundit të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin para afatit të komandimit të z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Kurushi.

Pati një pauzë për shkak edhe të kohëzgjatjes së kësaj mbledhjeje. Ishte një pushim i shkurtër në raport me efektivitetin e gjykimit të akteve dhe të vlerësimit si duhet të tyre.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, po filloj me relacionin e radhës për ta prezantuar përpara Këshillit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të Ligjit nr.115/2016 si dhe në nenet 53, 54, 57 he 58, të Ligjit nr.96/2016, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 425, datë 14.10.2022 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë për: Pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” ka vendosur: “Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Ministrinë e Drejtësisë, për: Pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.

Brenda afatit të kandidimit për komandimin në pozicionin si më lart kandidoi z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës në kohën e aplikimit, tashmë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

Në përfundim të procedurës së komandimit, sipas përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit nr.96/2016 si dhe atyre që vijoj në si është vendimit të Këshillit nr. 425, datë 14.10.2022, pas vlerësimit të plotësimit të kriterëve të komandimit, me vendimin nr. 538, datë 14.12.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

“1. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë, për një afat pesëvjeçar. 2. Afati i komandimit fillon më datë 1 janar 2023. 3. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. 4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtarit nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.”

Aktualisht, pranë Këshillit është depozituar shkresa nr. {...} prot., datë 26.02.2024 e Ministrisë së Drejtësisë, me lëndë: “Mbi përfundimin e komandimit të magjistratit pranë Ministrisë së Drejtësisë”.

Në këtë shkresë, Ministria e Drejtësisë vë në dijeni Këshillin për situatën e krijuar dhe kërkon përfundimin e komandimit pranë Ministrisë së Drejtësisë të magjistratit gjyqtar z. {...}, si më poshtë: “Në vijim të VKM nr. 29, datë 17.01.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për administratën publike dhe antikorrupsionin”, ku ndër të tjera është caktuar Ministri i Shtetit për Administratën

Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, ju informojmë si vijon: Sipas vendimit nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit”, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit drejton Rrjetin e Koordinatorëve kundër Korrupsionit, i cili përbëhet nga koordinatorët kundër korrupsionit të emëruar pranë disa institucioneve në nivel qendror dhe rajonal dhe struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo e fundit organizohet në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e strukturës dhe përgjigjet përpara Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Bazuar në ligjin nr.115/2016, në ligjin nr. 96/2016, nga data 1 janar 2023 magjistrati gjyqtar z. {...} është komanduar me Vendimin tuaj nr. 538, datë 14.12.2022 në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Aktualisht struktura përgjegjëse kundër korrupsionit vijon të jetë pjesë e organikës së Ministrisë së Drejtësisë, por është përgatitur projektvendimi “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i cili shumë shpejt do të propozohet në Këshillin e Ministrave për miratim nga ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Në këto kushte, vlerësojmë se është e rëndësishme t’ju informojmë paraprakisht mbi situatën e krijuar, ku struktura antikorrupsion në të cilën gjyqtar z. {...} ushtron detyrën, do të ndryshojë varësi (nga Ministria e Drejtësisë në Ministrinë e Shtetit).

Sa më lart, kërkojmë nga ju përfundimin e komandimit të magjistratit gjyqtar z. {...}.”

Lidhur me këtë shkresë të Ministrisë së Drejtësisë është vënë në dijeni nëpërmjet postës elektronike edhe magjistrati i komanduar z. {...}, i cili është shprehur se: “Ju faleminderit për njoftimin. Konfirmoj marrjen dijeni. Vendimmarrjen e lë në vlerësimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se është vendi për të përfunduar përpara afatit komandimin e z. {...} për arsyet që do të argumentohen më poshtë.

Në vendimin nr. 538, datë 14.12.2024, Këshilli ndër të tjera ka vendosur: “ ... 3.

Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenimin e funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.”.

Ndërsa në nenin 57, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “2. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara”.

Asnjë nga këto raste nuk përfshihet në situatën në të cilën gjendet komandimi i magjistratit z. {...}, pasi kërkesa vjen nga institucioni në kushtet kur institucioni për të cilën është shpallur dhe vlerësuar gjithë procedura e komandimit, nuk do të ketë më në varësi këtë pozicion.

Komisioni vlerëson se nuk ka më objekt të komandimit të pozicionit të parashikuar sipas vlerësimit të bërë me vendimin nr. 538, datë 14.12.2024, ku Këshilli ndër të tjera ka vendosur: “1. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë. Për këtë institucion dhe pozicion Këshilli ka analizuar përshtatshmërinë e pozicionit në raport me funksionin e magjistratit sipas pikës 2 të Nenit 53 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe magjistratëve në Republikën e Shqipërisë“, ku parashikohet se: “Institucioni në të cilin magjistrati komandohet”, për pozicionin e ndihmësmagjistratit është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese ose Prokuroria e Përgjithshme; për pozicionet si inspektorë është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; dhe për pozicione të tjera janë Këshillat, Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit, Shkolla e Magjistraturës ose çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit si dhe organizatat ndërkombëtare.”

Në rast se do të pranohet se do të përfundojë komandimi i z. {...} pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe të vijojë komandimi i z. {...} në strukturën e re, do të ndodheshim përpara rastit të një komandimi të ti ri, i cili bie në kundërshtim me parimet bazë të komandimit të parashikuar në pikën 7 të nenit 53 sipas të cilit “7. Magjistrati duhet të shërbejë jo më pak se pesë vjet si magjistrat pas përfundimit të periudhës së komandimit.”

Mbajtur në konsideratë situatën e krijuar ku institucioni për të cilin është shpallur kërkesa për komandim nuk e ka më këtë pozicion në varësi, kërkesën e ka bërë vetë institucioni, Ministria e Drejtësisë, njëkohësisht është marrë dijeni edhe nga gjyqtari i komanduar, dhe ndodhur në këtë situatë, Komisioni propozon projektvendimin “Për përfundimin para afatit të komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë.”

Ky projektvendim është i hartuar në 4 pika.

Në pikën e parë parashikohet - Përfundimi para afatit i komandimit të gjyqtarit në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike të këtij vendimi, i cili nisur nga situata e krijuar propozohet që të ketë efekt të menjëhershëm.

Në vijim parashikohet se një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, gjykata ku magjistrati ka caktimin e përhershëm si edhe Ministrisë së Drejtësisë.

Në vijim parashikohet e drejta e ankimit kundër këtij akti, me përmbajtjen se kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundmi parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po, fjala për ju zonja Muçi.

Emona Muçi: Pasi dëgjuam në lidhje me relacionin e përgatitur, unë kam vetëm një pikëpyetje në lidhje me respektimin ashtu siç është shkruar në nenin 57 të ligjit, në

lidhje me përfundimin e komandimit të magjistratit. Ligji thotë se komandimi përfundon me përfundimin e afatit apo me përfundimin e afatit të ripërsëritur, ndërkohë që pika 2 thotë që me kërkesë të magjistratit duke marrë edhe mendimin e institucionit ku është komanduar për arsye të justifikuara përfundon komandimi.

Në rastin konkret neve kemi një kërkesë të institucionit dhe marrje mendimi të magjistratit që mendoj që duhet të respektojmë ligjin duke i bërë me dije magjistratit për situatën e re të krijuar në lidhje edhe me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë dhe më tej ta pyesim në qoftë se magjistrati dëshiron të paraqesë kërkesë, pra nuk mund të marrim si të mirëqenë fjalinë e tij “në çmimin tuaj”, se nuk më duket korrekte. Magjistrati duhet të ushtrojë funksionin e tij në përputhje me të gjitha kufizimet e ligjit; në momentin që ai vihet në dijeni që funksioni i tij po pengohet qoftë edhe nga miratime strukturash apo ndryshim varësish të institucionit ku është komanduar, ai duhet të tregohet diligjent, në kuptimin e bërjes së kërkesës, sikurse të na vendosë edhe në dijeni në lidhje me situatën e re të krijuar, me qëllim që të marrim një vendimmarrje.

Për këtë arsye unë propozoj t’i kërkojmë, t’i vëmë në vëmendje magjistratit në lidhje me shkresën, në qoftë se e ka marrë, duhet patjetër të na japë pëlqimin të bërjes apo jo të kërkesës, me qëllim të vijimit të vendimmarrjeve. Për secilën ka vendimmarrje të ndryshme dhe ligji e ka parashikuar. Kjo është kërkesa ime, pra drejtuar magjistratit i cili të paraqesë kërkesë ose jo.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi!

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, ose s’është kuptuar problemi ose keqinterpretohet dispozita. Në rastin konkret, parimet e përgjithshme të komandimit janë përcaktuar në nenin 53 i cili përcakton që magjistrat mund të lëvizin në një detyrë jomagjistrati duke krijuar fleksibilitet në skemë dhe njëkohësisht ruan garancinë statuore të magjistratit, që në përfundim ai të rikthehet në vendin e punës. Në pikën 2 të nenit 53, përcaktohen njëkohësisht edhe institucionet ku kanë të drejtë magjistratët të komandohen. Rasti

konkret e do që vetë ministria e cila para disa kohësh ka kërkuar komandimin dhe ndihmën e një magjistrati për të përmirësuar eksperiencën e ministrisë me përmbushjen e detyrimeve, sidomos në Drejtorinë Antikorrupsion, duke kërkuar edhe hapjen e një ftese për të gjithë magjistratët për t'u komanduar pranë kësaj drejtorie, me qëllim edhe shkëmbimin e eksperiencës në këtë fushë, ka konsistuar në faktin që aktualisht për shkak të një vendimi të qeverisë, ky departament (drejtori), të transferohet diku tjetër në një ministri pa portofol dhe që nuk bën pjesë tek neni 2. Ai që duhet të supervizojë skemën e komandimit sipas nenit 53 e në vijim, është KLGJ-ja e cila ruan kriteret dhe shikon kriteret, respektimin e kriterëve dhe kushteve të komandimit. Në rastin konkret institucioni ku përfundoi departamenti antikorrupsion nuk bën pjesë në asnjë nga institucionet e drejtësisë, për të cilën ne kemi detyrim t'i përgjigjemi me komandim, përpos faktit që vetë ata që kanë kërkuar komandimin kanë konfirmuar faktin që nuk bën pjesë në fushën juridiksionale lëndore të kësaj ministrie pjesa e aktivitetit antikorrupsion. Kështu që, në këtë aspekt nuk ka nevojë të disponojmë dëshirën e magjistratit sepse komandimi ka humbur thelbin. Institucioni i cili ka kërkuar komandimin me kriteret dhe kushtet e përcaktuara që në krye të herës dhe duke bërë dhe ftesë për të gjithë magjistratët, tashmë ka përfunduar dhe është transferuar në një institucion tjetër që nuk i takon institucionit të drejtësisë. Kështu që në këtë aspekt, duke qenë që komandimi ka si pasojë fundore kthimin tek vendi i punës, do të ishte më se normale që me njoftimin nga ana e ministrisë të këtij fakti juridik të ndryshimit të departamentit nga Ministria e Drejtësisë tek një ministri pa portofol, duke humbur dhe thelbin e komandimit, KLGJ, e cila duhet të verifikojë dhe të ruajë respektimin e këtyre kriterëve të komandimit, të bëjë menjëherë disponimin duke e dërguar magjistratin në detyrën funksionale pranë gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme. Rasti i nenit 57 trajton tema të tjera kur vetë magjistrati për shumë shkaqe të arsyeshme e shikon që e ka të pamundur të ofrojë shërbimin e tij në pozicionin e ndihmësmagjistratit në vendin ku ai është komanduar, dhe në këtë moment, përsëri është KLGJ-ja ajo që pasi merr parasysh shkaqet, vendos ta kthejë magjistratin atje ku është caktuar. Kështu që po marrim edhe rastin hipotetik sikur magjistrati shpreh dëshirën që unë do vazhdojë tek departamenti i ministrisë pa portofol, a do të kishte një vendimmarrje të KLGJ-së t'ia njihte këtë komandim? Unë do të them

që në opinionin tim dhe në bazë të parimeve që ka përcaktuar të gjithë dispozitat nga 53 deri në fund, nuk ka asnjë rast ku neve mund të marrim një vendimmarrje për të plotësuar dëshirën e magjistratit për ta komanduar në një institucion i cili nuk bën pjesë tek parashikimet e nenit 53/2, pasi pikërisht garancia statuore kjo është, që komandohet gjithmonë magjistrati në pozicionet e niveleve të institucioneve të drejtësisë dhe në asnjë nivel tjetër, sepse gjyqtarët konsiderohen të profilit magjistraturë të veçantë, funksioni kryesor është të japin dhe të shpallin vendime. Në momente të caktuara konsiderohet e nevojshme për t'u komanduar në pozicionin jashtë profilit të tyre (të jomagjistratit pra), dhe këto institucione e kanë të përcaktuar nominalisht se ku mund të komandohesh. Pra me rënien e komandimit bie përfundimisht skema dhe si e tillë, e vetmja vendimmarrje në këtë rast do të ishte përfundimi i komandimit dhe dërgimi i magjistratit në pozicionin e përhershëm pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Kukës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Jam dakord me të gjitha ato që tha z. Toro.

Bile unë them që në këtë rast jo vetëm na ka njoftuar ministria, por edhe sikur të mos na njoftonte ministria, vetë magjistrati ka detyrim të na njoftojë për ndryshimet në rast se ai do kalonte në një strukturë tjetër, pasi do ishte në shkelje etike në rast se do të vijonte pa pëlqimin tonë. Kështu që unë them që jam dakord që në rast se do kishte një vendimmarrje të tillë, do kishte ndryshuar, neve ishim të detyruar kur do merrnim dijeni, se ne mund edhe të mos marrim dijeni, prandaj them që është detyrim i magjistratit të na njoftojë, por në këtë rast na ka njoftuar ministria. Unë doja ta theksoja që magjistratët kanë detyrimin të na njoftojnë, në rast se ndryshon pozicioni. Në këtë rast akoma s'ka ndryshuar. Kështu që nuk mund t'i kërkoj llogari magjistratit pse s'ka vënë në dispozicion, pse s'ka kërkuar një gjë të tillë, na ka vënë në dijeni ministria. Kështu që unë jam dakord. Thjesht ishte për të përforcuar që është edhe detyrim i magjistratit.

Ilir Rusi: Po, zonja Muçi!

Emona Muçi: U duk sikur unë iu referova diçkaje tjetër.

Unë i jam referuar kreut të komandimit i cili ka disa nene, 53 janë parimet, procedura, komandimi pranë institucioneve dhe 57 është neni i cili i referohet përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit, që përfshin përfundimin e rregullt, në paragrafin e parë, që thotë “në përfundim të afatit ose afatit të ripërsëritur”, i cili është afati maksimal dhe në paragrafin e dytë ka përjashtimin nga rregulli para afatit. Ne këtu kemi një ndërprerje komandimi para një afati dhe për t’i dhënë edhe përgjigje pyetjet ose eventualitetit në rast se ky magjistrat nuk dëshiron ose dëshiron të vijojë aty ku ai është tashmë i komanduar, kam mendimin se në rast se do të shprehë dëshirën për të vijuar edhe kur ndryshon institucioni dhe nuk është më sipas atyre të përcaktuar në nenin 53/2, magjistrati në këtë rast po vepron, po ushtron funksionin e tij në kundërshtim, domethënë po e ushtron në papajtueshmëri dhe me kufizimet që ka parashikuar ligji nuk është në rregull.

Klodian Kurushi: Mundet të sqaroj një moment të vogël.

Ilir Rusi: Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Nuk jemi në situatën hipotetike. Magjistrati normalisht sot po ushtron funksionin e tij ashtu siç është ngarkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, e para. E dyta, procedura që i referohemi nenit 57 të ligjit “Për statusin”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në këtë situatë që ne mendojmë që është, referuar edhe relacionit, pak e veçantë për shkak të suprimimit të pozicionit, por për ta koreluar situatën e krijuar me mënyrën se si duhet të ushtrojë funksionet komisioni dhe Këshilli, jo pa qëllim i ka kërkuar mendim magjistratit dhe këtë mendim magjistratit ia ka kërkuar për faktin e njohjes me situatën dhe dëshirave ose vullnetit se çfarë ai mendon për të vijuar më tej në këtë lloj situatë që është krijuar. Kështu që mendoj që edhe atë shqetësim që ndoshta është ngritur këtu, kam përshtypjen se e ka shteruar komisioni nëpërmjet dhënies së mundësisë magjistratit për të dhënë mendimin e tij në lidhje me situatën tashmë të krijuar jo për fajin e tij, por që është

krijuar për shkak të suprimimit të pozicionit.

Thjesht kjo ishte për të sqaruar më tej anëtarët e Këshillit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Në vijim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, pas prezantimit të relacionit nga zoti Kurushi, diskutimeve të anëtarëve, zonja Muçi kërkon përsëri fjalën për të perfrazuar propozimin në lidhje me vijueshmërinë e shqyrtimit të këtij akti.

Emona Muçi: Atëherë, propozimi im, duke u bazuar në nenin 57 të ligjit për statusin, konkretisht në pikën 2, Këshilli të zbatojë procedurën, pra pikën 2, sipas mendimit tim, duke iu drejtuar magjistratit me qëllim për të paraqitur kërkesë në lidhje me mendimin e dhënë nga institucioni (Ministria e Drejtësisë) për ndryshimin e varësisë së drejtorisë në të cilën ky magjistrat është komanduar.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka propozime të tjera?

Atëherë vazhdojmë me votimin e propozimit të zonjës Muçi.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Jam kundër, pasi është jashtë kontekstit të nenit 57/2, plus në mungesë të shkakut të komandimit, pra nuk ekziston shkak i komandimit pasi institucioni i cili duhet të vijonte komandimin e ka larguar strukturën në një institucion tjetër i cili nuk bën pjesë në institucionet e drejtësisë. Më duket irelevante fakti i marrjes së konfirmimit nga ana e ministrisë apo kushdo qoftë tjetër. Faleminderit!

Fatmira Luli: Kundër, për arsyen, sepse kjo kërkesë është ezauruar nga komisioni, është pyetur gjyqtari nëse do të vazhdojë apo jo, të shprehë interesin, dhe ka thënë e kam lënë në çmim të Këshillit dhe kjo ka një arsye, për të mos u konsideruar që

po përfundon afati i komandimit me kërkesën e tij. Ai do që t'i njihet kjo periudhë dhe do që të mbarojë komandimi për shkaqe jo objektive dhe jo me kërkesë. Kështu që për këto arsye jam kundra.

Markelian Koça: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Illir Rusi: Kundër.

Illir Rusi: Pas mosmiratimi të propozimit të zonjës Muçi, vazhdojmë me votimin e projektvendimit të paraqitur nga Komisioni.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin para afatit të komandimit të z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin para afatit të komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Ministrisë së Drejtësisë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike, u shqyrtuan të gjitha pikat e këtij rendi dite dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë!

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor